

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"
MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Ardiana Rama
Mitrovicë, 2021

**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"
MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR**



PUNIM DIPLOME

**EFEKTET E TË MËSUARIT PËRMES
PROJEKTEVE NË FUSHËN E SHKENCAVE TË
NATYRËS**

Mentor:

Prof. Dr. Qerim Selimi

Kandidati/ja:

Ardiana Rama

Mitrovicë, 2021

**UNIVERSITY “ISA BOLETINI”
MITROVICA
FACULTY OF EDUCATION
PRIMARY PROGRAM**



DIPLOMA THESIS

**EFFECTS OF LEARNING PROJECTS IN THE
FIELD OF NATURAL SCIENCES**

Supervisor:

Prof. Dr. Qerim Selimi

Candidate:

Ardiana Rama

Mitrovica, 2021

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE NË ARSIMIN FILLOR

Titulli i punimit: EFEKTET E TË MËSUARIT PËRMES PROJEKTEVE NË FUSHËN E SHKENCAVE TË NATYRËS

Emri dhe mbiemri: Ardiana Rama

Statusi i studentit: E rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri) : 1406011086

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentori/ja i/e punimit: Prof.Dr. Qerim Selimi.

Aprovuar prej komisionit:

1. Prof. Dr. Qerim Selimi, mentor

/Emri Mbiemri, Titulli /

2. _____, kryetar

/Emri Mbiemri, Titulli /

3. _____, anëtar

/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

Deklarata e autorësisë

Unë Ardiana Rama, nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim diplome me titull “*EFEKTET E TË MËSUARIT PËRMES PROJEKTEVE NË FUSHËN E SHKENCAVE TË NATYRËS*” është shkruar nga unë, nuk është prezantuar asnjëherë para meje në ndonjë institucion tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Përveç rasteve të cituara dhe të referuara, punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër.

Ardiana Rama_____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

FALËNDERIM

E falënderoj së pari mentorin e temës Prof. Dr. Qerim Selimi për temën e përzgjedhur dhe ndihmën e vazhdueshme deri në përfundimin e saj.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë mësimitdhënësit e UMIB- Fakulteti i Edukimit, që ishin të gatshëm në çdo kohë të ndajnë njohuritë e tyre me ne, falenderoj anëtarët e komisionit vlerësues dhe mësimitdhënësit e shkollave të Komunës së Vushtrris të cilët ishin të gatshëm për bashkëpunim, me të cilët u realizua ky punim kërkimor.

Një falënderim të veçantë e meriton familja ime, nga të cilët motivohem për çdo hap timin në jetë.

Po ashtu, të gjithë atyre që më ndihmuan në çfarëdo mënyre në realizimin e kësaj teme të diplomes, si familjarë, miq e kolegë, u jam mirënjohëse përherë.

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	VIII
LISTA E FIGURAVE	VIII
LISTA E SHKURTESAVE	IX
ABSTRAKTI	X
ABSTRACT	XI
HYRJE	XII
1. HISTORA E TË NXËNIT TË BAZUAR PROJKE	13
1.1. <i>Përkufizimi i mësimi të bazuar në projekte</i>	14
1.2. <i>Komponentët e të nxënit të bazuar në projekte</i>	15
1.3. <i>Lënda mësimore-shkencat e natyrës e bazuar në projekte</i>	16
1.4. <i>Roli i mësuesit</i>	17
2. METODOLOGJIA	18
2.1. <i>Dizajni hulumtues</i>	19
2.2. <i>Pjesëmarrësit</i>	19
2.3. <i>Instrumenti</i>	20
2.4. <i>Mënyra e mbledhjes së të dhënave</i>	20
2.5. <i>Analizat</i>	20
2.6. <i>Etika hulumtuese</i>	20
2.7. <i>Kufizimet e hulumtimit</i>	20
3. REZULTATET E HULUMTIMIT	21
4. DISKUTIMI	24
5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME	27
LITERATURA	28
SHTOJCAT	29

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Analiza e variablës "Pjesëmarrësit e hulumtimit të ndarë sipas vendbanimit".....	19
--	----

LISTA E FIGURAVE

Grafiku 1. Analiza e variablës "A keni marrë pjesë në trajnime në lidhje me efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës?".....	20
Grafiku 2. Analiza e variablës "A mendoni se duhen më tepër trajnime për aplikimin e projekteve për të mësuarit e shkencave të natyrës?"	21
Grafiku 3. Analiza e variablës " Sa shpesh aplikoni projekte për të mësuarit e shkencave të natyrës gjatë një periode?"	21
Grafiku 4. Analiza e variablës "A mendoni se aplikimi i projekteve në procesin e mësimnxënies së shkencave të natyrës?"	22
Grafiku 5. Analiza e variablës "A shfaqin fëmijët interesim në të nxënë kur aplikoni projekte për mësimdhënie të shkencave të natyrës?".....	22

LISTA E SHKURTESAVE

MASHT-*Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;*

DKA-*Drejtoria Komunale e Arsimit;*

E-Mësimi-*Mësimi Elektronik.*

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të dihet se cilat janë efektët e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës. Të shihet se sa e aplikojnë mësimeve projektet gjatë procesit mësimorë, sa efektiv është aplikimi i këtyre projekteve në procesin mësimorë me theks në shkencat e natyrës dhe se sa zgjon interesim dhe motiv tek nxënësit. Gjithashtu të dihet se sa i efektshëm është mësimi përmes projekteve në shkencat e natyrës dhe sa mund të nxënë fëmijët përmes zhvillimit të mësimit përmes kësaj metode.

Të dhënat janë mbledhur me anë të pyetësorit, i cili përbëhet nga 12 pyetje prej të cilave 4 janë pyetje demografike dhe 8 pyetje në lidhje me temën e hulumtimit. Të dhënat janë relizuar me programin statistikor të shkencave shoqërore SPSS 20, duke përdorur analizat përshkruese, analizat e korrelacionit si dhe është bërë analiza e besueshmërisë së pyetësorit.

Rezultatet e hulumtimit treguan se mësimeve projektet nuk aplikojnë në masë të duhur projekte, në rastet kur e aplikojnë mësimi del të jetë i suksesshëm dhe mjaft efektiv, nxënësit kanë më tepër interesim dhe motiv të mësojnë në këtë mënyrë.

Fjalët kyqe: mësimeve projektet, nxënësit, proces mësimor, zbatim, projekt, shkenca të natyrës.

ABSTRACT

The aim of his research is to know what are the effects of learning during the project in a field of natural science. See how teachers apply design during the learning process, so that it is effectively implemented in case it is projected in the learning process with emphasis on natural science and prolonging the interest and motivation of students. In addition, you need to learn to use projects in the natural sciences and in order to use another method if you use another way of learning.

Data were collected through a questionnaire, which consists of 12 questions of which 4 are demographic questions and 8 questions related to the research topic. The data were analyzed with the statistical program of social sciences SPSS 20, using descriptive analysis, correlation analysis and the reliability analysis of the questionnaire.

The results of the research showed that teachers do not apply projects properly, in cases when they apply the teaching turns out to be successful and quite effective, students have more interest and motivation to learn in this way.

Keywords: teacher, student, learning process, implementation, project, natural sciences.

Hyrje

Mësimi i bazuar në projekte është një qasje udhëzuese e krijuar për t'u dhënë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuri dhe aftësi përmes projekteve angazhuese të vendosura rreth sfidave dhe problemeve që ata mund të hasin në botën reale (Schuetz, 2018). Referenca e parë në lidhje me mësimin e bazuar në projekte vjen nga fillimi i shekullit të 20-të. Mësimi i bazuar në projekt përshkruhet nga shumë përkufizime. Secili prej këtyre përkufizimeve përmban zgjidhjen e një problemi nga grupi i studentëve. Me këtë metodë është roli i mësuesit është I ndryshëm i në krahasim me mësimin tradicional. Mësuesi duhet të jetë lehtësues shumë i mirë për zbatimin e suksesshëm të kësaj metode në kurrikulë.

Mësimi i bazuar në projekt i përket një metode, e cila mund të zhvillojë mendimin e nxënësve, të krijojë zgjidhje origjinale, të zhvillojë punë bashkëpunuese, të gjejë burime të disponueshme letrare, të paraqesë gjetjen e informacionit dhe të vlerësojë gjetjet e veta (Doppelt, 2000). Siç shihet, kjo metodë ka pasur ndikim pozitiv te nxënësit ose studentët, por duhet të përdoret gjatë mësimdhënies. Është e nevojshme të arsimohen mësuesit e ardhshëm, sepse pa bazë cilësore, nuk mund të presim, realizimin e mësimëve të bazuara në projekte në shkollat fillore ose të mesme.

I. HISTORA E TË NXËNIT TË BAZUAR PROJKETE

Referenca e parë për të mësuarit e bazuar në projekte u përmend në punën e Kilpatrick (Kilpatrick,1981), i cili besonte se përdorimi i shkrim-leximit në kuptim kontekstet siguruan një mjet për ndërtimin e njohurive themelore dhe për arritjen e avancimeve personale. Ai sugjeroi që projektet të jenë matematikë ndër-disiplinore, shkenca natyrore, studime shoqërore për t'u siguruar nxënësve një koleksion të pasur konceptesh dhe idesh. Ai synonte që temat të vinin nga interesat e nxënësve, duke thënë se projektet e grupeve, të propozuara, të planifikuara, të paraqitura dhe të vlerësuara nga mësuesit do t'i ndihmonin nxënësit të zhvillonin një kuptim të jetës së tyre gjatë përgatitjes për të punuar brenda një demokracie. Mësimi i bazuar në projekte gjithashtu pasqyron një këndvështrim Vygotskian (Berk, Winsler, Adam,1995). Vygotsky teorizon se të mësuarit ndodh përmes ndërveprimit shoqëror që inkurajon nxënësit të merren me sfidat e njohura të llojit që janë pak më lart se nivelet e tyre të tanishme të aftësisë. Këta nxënës mund të modelojnë zgjidhjen e problemeve, të ndihmojnë në gjetjen e zgjidhjeve, të monitorojnë progresin dhe vlerësojnë suksesin.

1.1. Përkufizimi i mësimit të bazuar në projekte

Mësimi i bazuar në projekte është një metodë udhëzuese e përqendruar te nxënësi. Në vend që të përdorë një plan të ngurtë mësimit që drejton një nxënës në një rrugë specifike të rezultateve ose objektivave të të nxënësit, të mësuarit në bazë të projektit lejon hetimin e thelluar të një teme që vlen të mësohet më shumë. Përmes ndërtimit të një artefakti me kuptim personal, i cili mund të jetë një lojë, një prezantim multimedial ose një poezi, nxënësit përfaqësojnë atë që kanë mësuar. Përveç kësaj, nxënësit zakonisht kanë më shumë autonomi mbi atë që mësojnë, duke ruajtur interesin dhe duke i motivuar nxënësit të marrin më shumë përgjegjësi për të mësuarit e tyre. Mësimi i bazuar në projekte mundëson shprehjen e larmisë tek nxënësit, siç janë interesat, aftësitë dhe stilet e të mësuarit. Mësimi i bazuar në projekt është një metodë për dhënien e kompetencave të të menduarit dhe krijimit të një mjedisi fleksibël të të mësuarit. Mësimi i bazuar në projekte ka një natyrë të eksplorimit të fushave të reja, zbulimit të çështjeve të reja shkencore dhe integritit të njohurive nga lëndë të ndryshme.

Koncepti i të mësuarit në bazë të projekteve ka një ngjashmëri me nocionin e ndërtimit të njohurive. Autorë të ndryshëm e përkufizojnë "të mësuarit" si një aktivitet që drejtohet për të përmirësuar strukturat mendore, ndërsa "ndërtimi i njohurive" drejtohet në përmirësimin e objekteve të njohurive të tilla si shpjegimet dhe modelet (Grant, 2002).

Qëllimi kryesor i të mësuarit përmes projekteve është një lidhje aktive e nxënësve me procesin arsimor. Situatat dhe pyetjet problematike krijohen nga mësuesit. Këto situata dhe pyetje nxisin mendime te nxënësit për temën. Skenarët e projektit nuk janë të hollësishëm dhe forma përfundimtare është bashkëpunimi me nxënësit. Realizimi i projektit varet nga nxënësit, nga krijimtaria, fantazia, mendimi kritik, motivimi i brendshëm, interesat dhe kërkesat e tyre. Mësuesit dhe nxënësit frymëzohen nga rrethina e tyre dhe nga problemet, të cilat krijohen nga jeta e përbashkët.

1.2. Komponentët e të nxënit të bazuar në projekte

Sipas Kleijer, Kuiper, De Wit dhe Wouters-Koster (Kleijer , Kuiper , De Wit , Wouters-Koster, 1981) janë katër karakteristika kryesore të të mësuarit përmes projekteve:

- 1) vetë-përgjegjësia për të menduarit dhe të mësuarit;
- 2) ndërgjegjësimi për përgjegjësinë shoqërore;
- 3) të menduarit dhe të vepruarit nga këndvështrimi shkencor, por në një zbatim praktik;
- 4) lidhja e procesit të grupit dhe produktit me praktikën profesionale

Komponentët e projektit dhe orientimi i tij janë pjesë e projektit me në qendër nxënësit. Mësimi i bazuar në projekte përmban disa karakteristika. Njëra nga këto është orientimi i problemit, është ideja që një problem apo pyetje të shërbejë për të nxitur aktivitetet e të nxënit. Karakteristika e dytë është ndërtimi i një artefakti konkret, i cili dallon të nxënit e bazuar në projekte nga të mësuarit e bazuar në problem. Në mësimin e bazuar në projekte, procesi i ndërtimit të një artefakti konkret (drafti i një modeli ose një produkti përfundimtar) i nxit nxënësit ose ekipin e nxënësve të mendojnë përmes hapave të procesit të ndërtimit, dhe në disa raste t'i ekzekutojë ato në mënyrë të rregullt si një ekip ndërtimi. Avantazhi mbi studimin tradicional është se boshllëqet në njohuri nuk mund të anashkalohen ose kapërcehen lehtësisht. Karakteristikë tjetër e kësaj metode është potenciali i saj për përdorimin dhe krijimin e formave të shumta të përfaqësimit. Në jetën moderne të punës, shumica e detyrave kërkojnë përdorimin e kombinuar të njohurive (ndërdisiplinore) në forma të ndryshme. Përparësia e kësaj forme të mëimdhënies dhe nxënies qëndron në faktin se ajo mundëson jo vetëm integrimin e njohurive nga disiplina të ndryshme, por edhe teori dhe praktikë me ç'rast nxënësit mund të shohin dhe ndiejnë realitetin me të cilin lidhen koncepte dhe ndërveprime të vështira.

Në ditët e sotme, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit është i lidhur me të mësuarit e bazuar në projekte. TIK sigurojnë një mjedis të pasur të të mësuarit dhe e ekspozojnë nxënësin në një shumëllojshmëri përfaqësimesh dhe konfigurimesh .

1.3. Lënda mësimore-shkencat e natyrës e bazuar në projekte

Natyrisht, mësimi i bazuar në projekte përdoret në lëndët shkencore, sepse hartimi i projekteve që do të jenë të rëndësishëm dhe interesante për nxënësit dhe dhënia e një mundësie për t'u bërë nxënës të pavarur nuk janë argumentet e vetme në favor të përfshirjes së mësimin të bazuar në projekte në mësimin e shkencës së natyrës. Kjo mundësi mund të ketë një ndikim të paçmuar në njohuritë e nxënësve për përmbajtjen, si dhe në vetëbesimin dhe vetë-efikasitetin e tyre ndaj shkencave të natyrës.

Projektet zgjerojnë përvojat e të nxënësve përtej klasës duke parashtruar pyetje drejtuese që e vendosin shkencën e natyrës me çështje që ka të ngjarë të jenë me interes për shkencëtarët, organizatat me bazë në komunitet dhe familjet. Ngjarjet ankoruese u sigurojnë nxënësve përvoja të përbashkëta që i ndihmojnë ata të shohin vlerën dhe qëllimin e pyetjes drejtuese (Blumenfeld, Soloway, Marx, Krajcik, Guzdial, Palincsar, 1991). Përvojat e ankorimit gjithashtu ndihmojnë nxënësit të lidhen me idetë e reja të hulumtuara në projekt. Përmes mbështetjes së mësuesve, nxënësit hartojnë dhe kryejnë hetime të ndryshme për të gjetur zgjidhje për pyetjet e projektit.

Integrimi i suksesshëm i të mësuarit të bazuar në projekte në procesin e mësimdhënies bazohet në tre dimensione. E para është natyra e njohurive dhe të mësuarit e bazuar në praktikë. Ai ndriçon marrëdhëniet midis njohurive, praktikave të punës, grupeve shoqërore dhe kontekstit shoqëror. Perspektiva e bazuar në praktikë jep një kontribut të veçantë duke diferencuar ato forma të njohurive që merren individualisht dhe ato që merren kolektivisht. Dimensioi tjetër është autonomia e projektit. Një aspekt i rëndësishëm i autonomisë së projektit është shtrirja e bashkë-vendndodhjes fizike midis anëtarëve të projektit. Bashkvendosja është identifikuar si një faktor i rëndësishëm në integrimin e njohurive midis anëtarëve të ekipit të projektit. Dimensioi i fundit quhet integrimi i njohurive, ai që identifikohet në shumë studime si një përbërës i rëndësishëm në inovacionin dhe të mësuarit (Kimonen, Nevalainen 2000). Nga një perspektivë e bazuar në praktikë, integrimi i njohurive brenda një projekti përfshin kapërcimin e pengesave në rrjedhën dhe transferimin e njohurive që vijnë nga ndarjet e praktikës para-ekzistuese midis anëtarëve të ekipit.

1.4. Roli i mësuesit

Roli i mësuesit nuk është më i vogël se ai i një instruktori që transmeton informacion dhe organizon aktivitete për praktikë, edhe pse më shumë ka rolin e një udhëzuesi dhe një lehtësuesi. Sidoqoftë, ai është një rol jo i lehtë.

Projektet kërkojnë që mësuesit të njohin interesat e nxënësve të tyre. Mësuesit duhet të dëgjojnë atë që është quajtur “momenti i mësimnxënies”, që tregon në një diskutim kur nxënësit entuziazmohen për një temë dhe fillojnë të bëjnë pyetje (Morgan, 1983). Lehtësimi i mësimit të bazuar në projekte kërkon një lloj aftësisht drejtuese, që i lejon mësuesit ta ndihmojnë një grup nxënësish të lëvizin në drejtimin që duan të shkojnë, duke treguar “kurthet” e mundshme, ose duke bërë sugjerime vetjake, pra kur nxënësit vendosin që më mirë t’i realizojnë idetë e tyre.

Jo të gjitha projektet janë të suksesshme. Disa mësues janë tepër të papërvojë për ta udhëhequr mirë procesin e tyre. Ata mund të presin shumë shkathtësi nga ana e nxënësve për ta marrë kontrollin e projektit pa i hedhur bazat e nevojshme, ose mund të dështojnë t’i lënë nxënësit ta marrin drejtimin vetëm atëherë kur munden. Nxënësit jo domosdoshmërisht marrin përsipër ta projektojnë një punë me gjithë zemër. Disa mund ta ndiejnë që mësuesit po heqin dorë nga rolet e tyre nëse nuk japin përgjigje, ose ata mund të mos dëshirojnë të mësojnë më as nga shokët e tyre të klasës.

Ende ekziston problemi me zbatimin e ulët të mësimit të bazuar në projekte në klasa. Disa mësimdhënës i paraqesin si problematike burimet e papërshtatshme materiale, kohë e pamjaftueshme për të krijuar kurrikula të reja, madhësia jo e përshtatshme e klasave, struktura administrative e mbikontrolluar; që i ndalon ata ta kenë autonominë e nevojshme për t’i zbatuar qasjet progresive (Heitmann, 1996). Sidoqoftë, problemi më i madh nuk qëndron te pajisjet shkollore, por te përgatitja universitare e mësuesit të ardhshëm. Nëse mësuesit e ardhshëm nuk marrin informacion të mjaftueshëm teorik dhe praktik, ata nuk do të praktikojnë mësim të bazuar në projekte në klasën e tyre.

II. METODOLOGJIA

2.1. Dizajni hulumtues

Hulumtimi " *Efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës*" është hulumtim me qasje sasiore.

Qëllimi i hulumtimit është që të dihet se sa aplikohen projekte gjatë procesit të mësimit në shkencave të natyrës, të shihet se a e lehtëson ose e vështirëson procesin e mësimit dhe se sa zgjon interesim te fëmijët kjo mënyrë e mësimit.

Gjatë punës sonë për realizimin e temës *Efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës* kemi paraparë edhe disa pika bosht për të pasur një ide më konkrete rreth fokusimit të temës. I kemi ngritur disa pyetje për të cilat mendojmë që, gjatë hulumtimit, do të kenë përgjigje të denjë dhe, po ashtu, kemi parashtruar hipotezat rreth këndvështrimit tonë paraprak për rezultatet e dhëna në këtë punim.

Pyetjet e hulumtimit:

- Sa aplikojnë mësuesit projekte gjatë realizimit të orës së shkencës së natyrës?
- Cilat janë efektet e mësimit dhe nxënies së mësimit të shkencës së natyrës të bazuar në projekte?
- Sa janë të trajnuar mësuesit për të zbatuar këtë formë të mësimit?

Hulumtimi është bazuar në dy hipoteza:

- **Hipoteza 1.** Aplikimi i projekteve gjatë procesit mësues në shkencat e natyrës përmirëson të nxëniet tek nxëniesit.
- **Hipoteza 2.** Infrastruktura shkollore nuk është në nivel të duhur për përdorim të projekteve të ndryshme në realizim të lëndës së shkencës së natyrës.

2.2. Pjesëmarrësit

Për shkak se këtë vit gjendemi në një gjendje pandemie e cila ka vërshuar botën, kam arritur që si pjesëmarrës t'i kem 42 mësues nga shkolla të ndryshme të Vushtrrisë. Prej tyre 38 i përkasin gjinisë femërore dhe 4 gjinisë mashkullore, ndërsa 28 janë me vendbanim urban dhe 14 me vendbanim rural. 9 prej tyre janë mësime të klasës së parë, 8 janë mësime të klasës së dytë, 9 janë mësime të klasës së tretë, 11 janë mësime të klasës së katërt dhe 5 janë mësime të klasës së pestë.

Tabela 1. Analiza e variables "Pjesëmarrësit e hulumtimit të ndarë sipas vendbanimit"

Vendbanimi				
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Urban	28	66.66	66.66	66.66
Rural	14	33.33	33.33	100
Gjithsej	42	100	100	

2.3. Instrumenti

Të dhënat e këtij hulumtimi janë mbledhur me anë të pyetësorit. Pyetësorët u realizuan me mësime të ciklit të ulët në Komunën e Vushtrrisë. Pyetësi është shpërndarë në mënyrë fizike. Pyetësi është i përbërë nga gjithsej 12 pyetje, ku pesë prej tyre janë pyetje demografike ndërsa shtatë të tjera janë pyetje që lidhen me temën e hulumtimit. Pyetjet janë kryesisht të mbyllura me përgjigje me anë të shkallës së Likertit. Pyetësi është kombinim mes tri pyetësorëve të dizajnuar nga: Enne Peterson, AISH/JMO, Jo Tondeur.

2.4. Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Nga shqyrtimi i literaturës prej autorëve të ndryshëm me temë të ngjashme sikurse tema e këtij hulumtimi është mbledhur material i vazhdueshëm për të vazhduar me punën në terren. Fillimisht

për realizim të punës në teren është dashur të merret leja nga DKA-ja, leje kjo që na jep të drejtën për realizim të hulumtimit nëpër shkolla. Pastaj pas miratimit të kërkeses edhe nga ana e drejtorëve të shkollave përkatëse bashkëpunuam edhe me mësimdhënësit të cilë pikpamjet e tyre i paraqiten përmes pyetësorëve.

2.5. Analizat

Të dhënat e mbledhura nga ky hulumtim janë analizuar me programin statistikor të shkencave shoqërore SPSS 20. Kryesisht janë përdorur analiza e frekuencave, analiza përshkruese dhe analiza e korrelacionit për t'i përshkruar lidhjet mes variablave të caktuara.

2.6. Etika hulumtuese

Gjatë këtij punimi është respektuar etika hulumtuese. Mësimdhënësve u është reguar se hulumtimi është vetëm për qëllim të studimeve dhe asnjë qëllim tjetër, si dhe të dhënat e tyre janë konfidenciale . Gjithashtu asnjërit prej tyre nuk iu është imponuar pjesëmarrja dhe u është treguar se në çdo moment që nuk e ndjejnë të nevojshme të vazhdojnë me plotësimin e pyetësorit mund ta ndërpresin atë.

2.7. Kufizimet e hulumtimit


Sikurse çdo hulumtim tjetër edhe ky hulumtim ka kufizimet e tij. Në të janë përfshirë vetëm gjatë shkolla të komunës së Vushtrris që krahasuar me numrin në total të shkollave që gjenden në Vushtrri është mostër e vogël. Një mostër e përbërë nga një numër më i madh i shkollave do të jepte padyshim rezultate më të besueshme. Ky hulumtim nuk është mbështetur në mendimet e nxënësve pasi që respondentë kanë qenë mësimdhënësit, përfshirja edhe e nxënësve do ta pasuronte akoma më tepër këtë hulumtim. Po ashtu pyetjet në pyetësorin e përdorur ishin të tipit të mbyllur që në njëfarë mënyre kanë kufizuar përgjigjet e pjesëmarrësve, e zëvendësimi i tyre me pyetje të hapura do të ofronte më shumë mundësi shprehjeje.

III. REZULTATET E HULUMTIMIT

Gjatë hulumtit tonë kemi vërejtur dukuri të ndryshme sa i përket gatishmërisë së mësimit, përkatësisht nxënësve për të punuar me projekte në shkencat e natyrës dhe njëherit kemi marrë disa rezultate jo edhe aq të parashikuara para realizimit të këtij punimi..

Në këtë kapitull do të paraqiten rezultatet e hulumtimit. Këto rezultate nxiren nga pyetësorët të cilët janë plotësuar nga 42 mësimit në 6 shkolla të Vushtrris të cilët ishin mostra e hulumtimit. Pas shqyrtimit të teorive dhe përdorimit të metodave dhe punës në terren janë arritur gjetjet e hulumtimit të cilat do paraqiten në vijim të nxjerra përmes analizave deskriptive.


Në pyetjen *A keni marrë pjesë në trajnime në lidhje me efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës?*; 31% e mësimit pohuan se kanë marrë pjesë në trajnime të tilla; 69% deklaruan se nuk kanë marrë pjesë..



Grafiku 1. Analiza e variablës “A keni marrë pjesë në trajnime në lidhje me efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës?”


Në pyetjen se *A mendoni se duhen më tepër trajnime për aplikimin e projekteve për të mësuarit e shkencave të natyrës?*; mësuesit deklaruan: 33% se këto trajnime janë jashtëzakonisht shumë të

nevojshme; 62% deklaruan se këto trajnime janë shumë të nevojshme; 5% pohuan se këto trajnime janë pak të nevojshme.



Grafiku 2. Analiza e variablës “*Sa shpesh aplikoni projekte për të mësuarit e shkencave të natyrës gjatë një periode?*”

Në pyetjen se *Sa shpesh aplikoni projekte për të mësuarit e shkencave të natyrës gjatë një periode?* mësimdhënësit deklaruan: 2% zbatojnë jashtëzakonisht shumë projekte të tilla; 45% zbatojnë shumë projekte, kurse 53% deklaruan se zbatojnë pak projekte të tilla.



Grafiku 3. Analiza e variablës “*A mendoni se duhen më tepër trajnime për aplikimin e projekteve për të mësuarit e shkencave të natyrës?*”

Në pyetjen *A mendoni se aplikimi i projekteve lehtëson procesin e mësimnxënies së shkencave të natyrës?* mësimdhënësit dhanë përgjigje pothuajse unanime, duke deklaruar se aplikimi i projekteve lehtëson procesin e mësimnxënies së shkencave të natyrës *jashtëzakonisht shumë* (36%), *shumë* (62%), *pak* (2%).



Grafiku 4. Analiza e variablës “A mendoni se aplikimi i projekteve lehtëson procesin e mësimnxënies së shkencave të natyrës?”

Në pyetjen se *A shfaqin fëmijët interesim në të nxënë kur aplikoni projekte për mësimdhënie të shkencave të natyrës?* mësimdhënësit u përgjigjën: *Jashtëzakonisht shumë* (26%), *Shumë* (64%), *Pak* (6%), *Aspak* (4%).



Grafiku 5. Analiza e variablës “A shfaqin fëmijët interesim në të nxënë kur aplikoni projekte për mësimdhënie të shkencave të natyrës?”

DISKUTIMI

Përvoja personale – në çfarëdo profesioni apo zanati – na pasuron ditë pas dite, si me njohuri, ashtu edhe me ide për të qenë të gatshëm për t'u gjendur në situata të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës e cila na është besuar. Njëjtë ndodh edhe me një mësimdhënës. Nuk thuhet kot që çdo mësimdhënës duhet të jetë fleksibil. Mirëpo, përkundër viteve që mund të na çojnë përpara si intelektualisht, ashtu edhe më të mbushur psikikisht, mungesa e bashkëpunimit me të tjerët mund të na lërë mangut në shumë aspekte. Prandaj, duhet të jemi bashkëpunues me të gjithë akterët e përfshirë në sistemin arsimor, sidomos me trekëndëshin kyç në mësimdhënie, siç është mësimdhënës-prind-nxënës; për rezultate sa më të larta në procesin edukativo-arsimor. Bashkëpunimi i mirëfilltë edhe me kolegët, ndjekja e seminareve të ndryshme dhe avancimi i vazhdueshëm në profesion, i begatojnë edhe më shumë këtë profesion fisnik dhe realizimi i rezultateve dhe kriterëve bëhet edhe më i lehtë.

Edhe gjatë realizimit të këtij punimi rreth pikëpamjeve të mësimdhënësve mbi efektin e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës, vërejtëm se, megjithëse ka dallime ndërmjet shkollave, respektivisht ndërmjet mësimdhënësve sa i përket procesit mësimor dhe praktikave që ndjekin ata, prapëseprapë të gjithë duhet t'u përmbahen kriterëve të caktuara, përmbushjes së kompetencave e arritjen e rezultateve të përcaktuara nga Kurrikula e Re e Kosovës, në kuadër të MASHT-it. Edhe pse forma e të mësuarit nuk ndërroi edhe aq në punën praktike, ana formale donte më shumë angazhim, duke pasur të parin kriter atë të bashkëpunimit ndërkolegial, si ndër kushtet e para për t'u arritur kompetencat e rezultatet e planifikuara. Bashkëpunimi edhe më herët ka qenë funksional, përkundër metodave e teknikave të ndryshme mësimore. Ky fakt patjetër që ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie e nxënie.

Ashtu si e kemi hasur në praktikat tona mësimore, edhe gjatë punës hulumtuese e pamë se mësimdhënësit, shumica prej tyre, shpesh dukej sikur nuk i përmbushnin të gjitha synimet që ata i kishin për ta realizuar orën mësimore. Meqë ne ishim të fokusuar te kjo e fundit, gjatë intervistimit të mësimdhënësve e diskutimit me ta, pamë një vullnet të përhershëm në aplikimin e projekteve të të mësuarit në fushën e shkencave të natyrës. Njëherit, edhe nxënësit qenkëshin

entuziastë kur bëheshin projekte të tilla shkollore. Shumica e bënin këtë më dëshirë, të kënaqur e duke dhënë më të mirën prej vetes për të dalë një projekt sa më i denjë përpara nxënësve të tjerë, mësimdhënësve, prindërve e familjarëve të tjerë pjesëmarrës në projekte e këtilla. Një pjesë fare e vogël e nxënësve deklaruan se e bëjnë këtë sa për ta kryer një obligim. Projektet e dimë se nuk janë të obligueshme për nxënësit, ngase ata me vetëdëshirë marrin pjesë në to. Por mësimdhënësit patjetër se duhet të gjejnë mënyra e metoda të ndryshme për t'i bindur ata.

Një sfidë më vete e realizimit të projekteve të tilla është mungesa e infrastrukturës në shkolla. Po ashtu, edhe mjetet financiare janë një problem serioz për avancimin e projekteve.

Sa i përket kushteve që ofron shkolla jonë, ato janë minimale, si nga ana e infrastrukturës, po ashtu edhe nga ajo financiare.

Faktori kohë është një element tjetër që paraqet problem në përgatitjen e duhur të nxënësve dhe gjithëpërfshirjen e tyre në projekte.

Pas realizimit të hulumtimit, pasi kemi shfrytëzuar librat bazë që lidhen me temën, duke analizuar tekstet shkollore të shkencës së natyrës së ciklit klasor, si dhe intervistimin e mësimdhënësve të ciklit klasor, po ashtu edhe pyetësin për mësimdhënësi, me anë të metodës kuantitative, dy hipotezat tona kanë dalë të sakta.

Hipotezat tona qenë:

- **Hipoteza 1.** Aplikimi i projekteve gjatë procesit mësimor në shkencat e natyrës përmirëson të nxënësit tek nxënësit.

Duke u bazuar në analizat e variablave "Përdorimi i projekteve ka efekte pozitive tek nxënësit në procesin e mësimnxënies" ku 35.71% e mësimdhënësve u deklaruan se e ka efekte pozitive jashtëzakonisht shumë dhe 61.9% prej tyre u deklaruan se e përmirëson shumë procesin e mësimdhënies, tregohet se të nxënësit zgjohet interesim më i madh në mësim kur aplikohen projekte, gjë e cila na lë të kuptojmë se aplikimi i projekteve përmirëson procesin e mësimdhënies dhe është mjaft i dobishëm si për mësuesin ashtu edhe për nxënësin.

- **Hipoteza 2.** Infrastruktura shkollore nuk është në nivel të duhur për përdorim të projekteve të ndryshme në realizim të lëndës së shkencës së natyrës.

Megjithëse mësimdhënsit për të realizuar projekte të shkencave të natyrës, disa edhe hezitonin, për shkak të mungesës së infrastrukturës shkollore si mungesa e pasisjeve teknologjike dhe faktori kohë është një element tjetër që paraqet problem në përgatitjen e duhur të nxënësve dhe gjithëpërfshirjen e tyre në projekte.

KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Konkludime

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi vijmë në përfundim se:

- Numri i trajnimeve të mësimdhënësve për aplikimin e projekteve është mjaft i ulët.
- Aplikimi i projekteve në shkencat e natyrës ka efekte pozitive në mësimdhënie dhe mësimnxenie.
- Projektet në shkencat e natyrës nuk aplikohen mjaftueshëm gjatë një periode.
- Infrastruktura shkollore lë shumë për të dëshiruar për aplikimin e projekteve në shkencat e natyrës.
- Nxënësit gjatë përfshirjeve në projekte të të mësuarit të shkencave të natyrës bëhen më social, bashkëpunues dhe zhvillojnë mendimin kritikë.

Rekomandime

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi gjithashtu mund të bëhen edhe disa rekomandime:

- Ndjekja e trajnimeve të cilat lidhen me aplikimin e projekteve në shkencat e natyrës.
- Përdorim më të theksuar të projekteve mësimore nga mësimdhënësit gjatë realizimit të mësimimit në shkencat e natyrës.
- Përfshire sa më të madhe të nxënësve në projekte të të mësuarit të shkencave të natyrës.
- Të shpërblehen nxënësit pjesmarrës në projekte të të mësuarit të shkencave të natyrës.
- MASHT-i të siguroj të siguroj kushte për shkollat me qëllim të aplikimit të projekteve nga ana e mësimdhënësve, që të kenë mundësi të shfrytëzojnë mjetet teknologjike gjatë punës së tyre me nxënësit.

LITERATURA

- [1] Robert Schuetz, *Project-Based Learning: Benefits, Examples, and Resources*, June 01, 2018.
- [2] Blumenfeld PC, Soloway E, Marx RW, Krajcik JS, Guzdial M, Palincsar A. *Motivating project-based learning: sustaining the doing, supporting the learning*. *Educ Psychol* 1991;26:369–398.
- [3] Grant MM. *Getting a Grip on project-based learning: Theory, cases and recommendations*. *Meridian* 2002;5:1-17.
- [4] Doppelt Y. *Implementation and assessment of project-based learning in flexible environment*. *Int J Technol Design Educ* 2000;13:255-272.
- [5] Kimonen E, Nevalainen R. *Active learning in the process of educational change*. *Teach Teach Educ* 2000;21:623-635.
- [6] Kleijer H, Kuiper R, De Wit H, Wouters-Koster L. *Project-based education between social idealism and educational possibility*. Amsterdam, SISWO, 1981.
- [7] Morgan A. *Theoretical aspects of project-based learning in higher education*. *British J Educ Technol* 1983;14:66–78.
- [8] Heitmann G. *Project-oriented study and project-organized curricula: A brief review of intentions and solutions*. *Eur J Eng Educ* 1996;21:121-131
- [9] Berk, Laura E. Winsler, Adam, *Scaffolding Children's Learning: Vygotsky and Early Childhood Education*. NAEYC Research into Practice Series. Volume 7, 1995.
- [10] Kilpatrick, W. H. *The Project Method: The Use of the Purposeful Act in the Education Process*. *Teachers College Record*, 1981,19: 319-335.

SHTOJCAT

SHTOJCA A

FORMULAR PAJTIMI

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICE

Rr.Parku Industrial, p.n. 40000 Mitrovicë

Republika e Kosovës



FAKULTETI I EDUKIMIT

FORMULAR PAJTIMI

I/E nderuar,

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të diplomës. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj hulumtimin me titull "*Pikëpamjet e mësimeve mbi aplikimin e teknologjisë në Komunën e Mitrovicës*". Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne

respektojmë zgjedhjen tuaj. Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me Ju, Ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj. Ofruesi i formularit

Një kopje e këtij konfirmimi mbetet tek Ju.

[Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në vazhdimësi, ju lutem kontaktoni profesorin udhëheqës të punimit, Prof.Dr. Qerim Selim, _____ në @umib.net].

SHTOJCA B.

PYETËSOR

Unë jam Ardiana Rama, studente e Fakultetit të Edukimit, Programi Fillor, në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Jam në përfundim të studimeve themeltare dhe për temë kam përzgjedhur *Pikëpamjet e mësimeve mbi efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës*. Pjesë e trajtimit të kësaj teme është edhe pjesa hulumtuese.

Ky hulumtim është pjesë e studimeve themelore (universitare), i cili zhvillohet për nevojë të studimeve, nën udhëheqjen e Prof. Qerim Selimi (mentor). Hulumtimi është anonim (nuk kërkohet dhe as nuk publikohet emër e mbiemër). Plotësimi i pyetësorit nuk merr kohë më shumë se 5 minuta. Ju lutemi për përgjigje të sigërta/sakta!

Vërejtje: Për secilën pyetje nga një përgjigje (me rumbullakësim të opsioneve pas pyetjes).

1. Vendbanimi

- a) urban
- b) rural

2. Gjinia

- a) femër

b) mashkull

3. Institucioni (Shkolla) ku punoni: _____

4. Klasa: _____

5. Numri i nxënësve në klasën tuaj:

a) <20,

b) 21-25,

c) 26-30,

d) 30+

7. Sa vite eksperiencë keni në profesionin tuaj?

a) <1 vit

b) 1-5 vjet

c) 6-10 vjet

d) Më shumë se 10 vjet

8. A keni marrë pjesë në trajnime në lidhje me efektet e të mësuarit përmes projekteve në fushën e shkencave të natyrës?

a) Po

b) Jo

9. A mendoni se duhen më tepër trajnime për aplikimin e projekteve për të mësuarit e shkencave të natyrës?

a) Jashtëzakonisht shumë

b) Shumë

c) Pak

- d) Aspak
- e) Nuk e di

10. Sa shpesh aplikoni projekte për të mësuarit e shkencave të natyrës gjatë një periode?

- a) Jashtëzakonisht shumë
- b) Shumë
- c) Pak
- d) Aspak

11. A mendoni se aplikimi i projektve lehtëson procesin e mësimit të shkencave të natyrës?

- a) Jashtëzakonisht shumë
- b) Shumë
- c) Pak
- d) Aspak
- e) Nuk e di

12. A shfaqin fëmijët interesim në të nxënë kur aplikoni projekte për mësime të shkencave të natyrës?

- a) Jashtëzakonisht shumë
- b) Shumë
- c) Pak
- d) Aspak
- e) Nuk e di